

UDHËZUES
PARAQITJA GRAFIKE
E DOKUMENTACIONIT
NDËRTIMOR

HYRJE	7
Objektivat	7
Struktura e udhëzuesit	7
Fushat e Aplikimit.....	8
Standardet.....	8
1. ORGANIZIMI, KOORDINIMI DHE KONTROLLIMI I TË GJITHA FAZAVE	
PËR PËRGATITJE TË DOKUMENTACIONIT NDËRTIMOR	8
1.1. Qëllimi.....	8
1.2. Mjetet e projektimit.....	8
1.2.1. Kriteret e kategorizimit	9
1.2.2. Rregullat e paraqitjes grafike	9
1.2.3. Përmbajtja e dokumentacionit ndërtimor për aplikim për leje ndërtimore	9
1.2.4. Lista kontrolluese e dokumentacionit ndërtimor.....	9
1.2.5. Shkëmbimi i informatave të dokumentacionit ndërtimor.....	10
1.3. Sigurimi i kualitetit të dokumentacionit ndërtimor	10
1.4. Koordinimi i përgjithshëm i hartimit të dokumentacionit ndërtimor	10
1.4.1. Të përgjithshme	10
1.4.2. Organizimi	11
1.4.3. Zhvillimet (plani dinamik)	11
2. ELEMENTET TEKNIKE KONVENCIONALE	11
2.1. Qëllimi dhe renditja	11
2.2. Shembujt e zbatimit sipas kornizës logjike.....	11
2.2.1. Projekti konceptual - Paraprojekti.....	11
2.2.2. Projekti ideor	12
2.2.3. Projekti kryesor	13
SHTOJCA A	15
A. 1. Dokumentacioni teknik i hartuar nga arkitekti	16
A. 2. Dokumentacioni teknik i hartuar nga inxhinierët e instalimeve të ndërtimit.....	17
A. 3. Skemë e shpërndarjes së planeve për një ndërtim kompleks	18
SHTOJCA B	19
B. 1. PLANET.....	20
B. 1.1. Formatet e fletës.....	20
B. 1.2. Palosja	20
B. 1.3. Tabelat	20
B. 1.3.1 Dimensionet dhe pozicionimet	20
B. 1.3.2. Përmbajtja	21
B. 1.3.2.1. Legjenda.....	21
B. 1.3.2.2. Fushat shtesë	21
B. 1.3.3. Përbërja	21
B. 1.3.4. Përpjesa	22
B. 2. ELEMENTET E TEKSTIT	22
B. 2.1. Të përgjithshme	22
B. 2.2. Rregulla e përbërjes.....	22
B. 2.3. Dimensionet e karaktereve	22
B. 3. VIJAT.....	23
B. 3.1. Trashësia e vijave	23
B. 3.2. Llojet e vijave	24
B. 3.3. Rastet e përdorimit	26
B. 4. RASTERAT (MODULET) DHE KOORDINATAT.....	28
B. 4.1. Rrjetat modulare të akseve.....	28
B. 4.2. Rrjetat modulare të konstruksionit	28
B. 4.3. Koordinatat	29

B. 5. DIMENSIONET DHE KUOTAT	29
B. 5.1. Të përgjithshme	29
B. 5.2. Njësitë matëse	29
B. 5.3. Kuotat e dimensionimit.....	30
B. 5.4. Kuotat e nivelit.....	31
B. 6. REFERENCAT E PËRFSHIRA NË PLAN	31
B. 6.1. Të përgjithshme	31
B. 6.2. Referencat dhe udhëzimet që figurojnë në të njëjtin plan	31
B. 6.3. Referencat dhe udhëzimet që figurojnë në plane të tjera	32
B. 7. PROJEKSIONET	32
B. 7.1. Mënyra e paraqitjes	32
B. 7.2. Projektionet normale.....	32
B. 7.3. Aksonometria.....	33
B. 8. VIZATIMET, SIMBOLET GRAFIKE DHE SHENJAT.....	34
B. 8.1. Të përgjithshme	34
B. 8.2. Topografia	34
B. 8.2.1. Paraqitja grafike e vijave kufizuese	34
B. 8.2.2. Simbolet grafike mbi vijat kufizues	34
B. 8.2.3. Pikat gjeodezike mbi simbolet grafike.....	35
B. 8.2.4. Pikat e gjeodezike mbi pikat e nivelit.....	35
B. 8.3. Materialet e ndërtimit	35
B. 8.3.1. Simbolet grafike	35
B. 8.4. Konstruksionet metalike	38
B. 8.4.1. Paraqitja grafike	38
B. 8.4.2. Dimensionimi	38
B. 8.4.3. Saldimet.....	38
B. 8.4.4. Bulonat.....	39
B. 8.4.4.1 .Simbolet grafike	39
B. 8.5. Konstruksionet e drurit	39
B. 8.5.1. Paraqitja grafike	39
B. 8.5.2. Dimensionimi	39
B. 8.5.3. Mënyrat e montimit.....	39
B. 8.5.3.1. Paraqitja grafike	39
B. 8.6. Instalimet elektrike, të telekomunikimit dhe informatike.....	40
B. 8.6.1. Simbolet grafike	40
B. 8.6.2. Akronimet	41
B. 8.6.2.1. Akronimet e instalimeve elektrike	41
B. 8.7. Instalimet e ngrohjes	42
B. 8.7.1. Të përgjithshme	42
B. 8.7.2. Simbolet grafike të pajisjeve instaluese	42
B. 8.7.3. Akronimet	43
B. 8.8. Instalimet e ventilimit	43
B. 8.8.1. Të përgjithshme	43
B. 8.8.2. Simbolet grafike të pajisjeve instaluese	43
B. 8.9. Instalimet sanitare	43
B. 8.9.1. Të përgjithshme	43
B. 8.9.2. Simbolet grafike të pajisjeve instaluese	43
B. 8.9.2.1. Pajisjet e instalimeve të ujit	43
B. 8.9.2.2. Shkarkimi i ujërave.....	44
B. 8.9.2.3. Pajisjet sanitare.....	44
B. 8.9.2.4. Akronimet	45
B. 8.10.1. Të përgjithshme	45
B. 8.11. Riparim - Renovim.....	45

B. 9. PARAQITJA GRAFIKE E ELEMENTEVE TË NDËRTIMIT	47
B. 9.1. Dritaret.....	47
B. 9.1.1. Të përgjithshme	47
B. 9.1.2. Simbolet grafike	49
B. 9.1.3. Akronimet	49
B. 9.2. Dyert	49
B. 9.2.1. Simbolet grafike	49
B. 9.2.2. Simbolet konvencionale	50
B. 9.2.3. Shkallët dhe rampat-pjerrinat	50
SHTOJCA C	53
C. 1. Vërejtje	54
C. 2. Dosja e Projektit Konceptual.....	54
C. 2.1. Përshkrimi tekstual i projektit konceptual përmban:	54
C. 2.2. Pjesa grafike e projektit konceptual	54
C. 2.3. Dimensionimi në projektin konceptual	54
C. 2.4. Projekti konceptual - Paraqitja grafike	55
C. 3. Dosja e projektit ideor	63
C. 3.1 Dimensionimi dhe kuotimi	63
C. 3.2. Projekti ideor - Paraqitja grafike.....	64
C. 3.3. Projekti i qasjes në rrjetin e kanalizimit të qytetit.....	69
C. 3.4. Projekti i qasjes në rrjetin e kanalizimit të qytetit - Paraqitja grafike.....	70
C. 4. Dosja e projektit kryesor	71
C. 4.1. Planet e niveleve, në përpjesë 1:50	71
C. 4.1.2 Prerjet, në përpjesë 1:50	71
C. 4.1.3 Dukjet (Fasadat), në përpjesë 1:50	71
C. 4.2 Dimensionimi dhe kuotimi	71
C. 4.2.1 Dimensionimi i bazave, në përpjesë 1:50	71
C. 4.2.2 Dimensionimi dhe kuotimi i prerjeve, në përpjesë 1:50	71
C. 4.2.3 Dimensionimi dhe kuotimi i dukjeve, në përpjesë 1:50.....	72
C. 4.3. Projekti kryesor - Paraqitja grafike	73
C. 5. Dosja e detajeve	77
C. 5.1 Përmbajtja dhe paraqitja	77
C. 5.1.1 Përpjesa	77
C. 5.1.2. Detajet e konstruksionit	77
C. 5.1.3 Detajet e pajisjeve sanitare.....	77
C. 5.2. Dimensionimi dhe kuotat.....	77
C. 5.3. Projekti kryesor - Paraqitja grafike	78
C. 6. Dosja e statikës, hartuar nga inxhinieri i ndërtimtarisë	84
C. 6.1. Përmbajtja dhe paraqitja	84
C. 6.2. Dimensionimi	84
C. 6.3. Projekti kryesor - Paraqitja grafike	85
C. 7. Dosjet e planeve, të hartuara nga inxhinierët e instalimeve hidroteknike, elektrike dhe makinerike.....	87
C. 7.1. Dosja e projektit kryesor	87
C. 7.2. Plani i detajeve	87
C. 7.3. Projekti kryesor - Paraqitja grafike	88
C. 8. Dosjet e projektit të riparimit-renovimit, hartuar nga arkitekti.....	91
C. 8.1 Projekti i gjendjes ekzistuese	91
C. 8.2 Projekti i intervenimeve	91
C. 8.3 Projekti final.....	91
C. 8.4. Projekti i renovimit - Paraqitja grafike.....	92
SHTOJCA D.....	101
Lista e standardeve	102

HYRJE

Objektivat

Udhëzuesi ka për qëllim të përshkruaj procedurën, rregullat dhe elementet konvencionale të vizatimit për hartimin e dokumentacionit ndërtimor (përshkrimin teknik, vizatimin teknik). Këto rregulla, në parim duhet të sigurojnë kualitet të paraqitjes grafike të punimeve, respektim të afateve kohore dhe kostos së ndërtimit si dhe unifikim të të gjitha fazave të projektit gjatë hartimit të pjesës grafike të dokumentacionit ndërtimor.

Hartimi i dokumentacionit ndërtimor nënkupton:

- Përmbajtjen dhe prezantimin e dokumentacionit ndërtimor
- Të gjitha fazat e projektimit, koordinimit, kontrollimit dhe shkëmbimit të dokumentacionit ndërtimor
- Përditësimin e dokumentacionit ndërtimor për punët e përfunduara
- Digjitalizimin e dokumentacionit ndërtimor

Këto rregulla iu dedikohen të gjithë atyre që marrin pjesë në hartimin dhe kontrollimin e dokumentacionit ndërtimor, me qëllim të përdorimit sistematik, uniform dhe racional të rregullave dhe elementeve konvencionale të vizatimit.

Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi përfshinë katër pjesë të cilat përshkruajnë procedurën e hartimit të dokumentacionit ndërtimor:

- 1. Organizimi, koordinimi dhe kontrollimi i të gjitha fazave për përgatitje të dokumentacionit ndërtimor** ([Shtojca A](#)).

Në këtë pjesë përshkruhen elementet për organizimin, koordinim dhe kontrollimin e dokumentacionit ndërtimor, e në veçanti:

- Kriteret e kategorizimit
- Rregullat e paraqitjes grafike
- Përmbajtja e dokumentacionit ndërtimor për aplikim për leje ndërtimore
- Lista kontrolluese e dokumentacionit ndërtimor
- Shkëmbimi i informatave të dokumentacionit ndërtimor
- Sigurimi i kualitetit

2. Elementet teknike konvencionale

Në këtë pjesë paraqiten rregullat e mëposhtme për hartim të dokumentacionit ndërtimor-paraqitja grafike ([Shtojca B](#)):

- Vizatimet teknike/planet
- Elementet e tekstit
- Vijat
- Rasterat-modulet dhe koordinatat
- Dimensionet dhe kuotat
- Shenjat e referimit të prerjeve dhe detajeve
- Projeksionet dhe perspektivat
- Emërtimet, simbolet dhe shenjat
- Paraqitja grafike e elementeve të ndërtimit
- Grafika digjitale (përpunimi i dokumentacionit në CAD)

3. Shembuj grafik të llojeve të projekteve

 ([Shtojca C](#))

Në këtë pjesë paraqiten shembujt e llojeve të projekteve. Përmbajtja dhe paraqitja grafike e projekteve sipas niveleve të projekteve të listuara më poshtë:

- Projekti konceptual
- Projekti ideor
- Projekti kryesor
- Projekti i riparimit-renovimit

4. Lista e standardeve

Në këtë pjesë paraqitet lista e standardeve, të cilat janë marrë si bazë për përgatitje të udhëzuesit.

Fushat e Aplikimit

Rregullat vlejnë për sektorin e projektimit dhe ndërtimit, duke pasur parasysh se këto sektore karakterizohen me punë ekipore mes arkitektëve, inxhinierëve të ndërtimtarisë dhe inxhinierëve të lëmive tjera të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme gjatë projektimit. Rregullat fillimisht janë përpiluar për të përmirësuar koordinimin dhe shkëmbimin e informatave në mes të hartuesve dhe shqyrtuesve të dokumentacionit ndërtimor.

Standardet

Ky udhëzues është hartuar duke u bazuar para se gjithash në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, udhëzimet administrative të derivuara nga këto ligje, dhe standardet ndërkombëtare të publikuara nga organizatat si:

- Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS)
- Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO)
- Komiteti Evropian për Standardizim (CEN)
- Normë zvicerane SIA 400:200 Construction - Élaboration de dossier de plans dans le domaine du bâtiment.

1 ORGANIZIMI, KOORDINIMI DHE KONTROLLIMI I TË GJITHA FAZAVE PËR PËRGATITJE TË DOKUMENTACIONIT NDËRTIMOR

1.1 Qëllimi

Udhëzimet në vazhdim i adresohen përgjegjësve të hartimit të dokumentacionit ndërtimor, për tu përdorë si rregulla të përgjithshme të organizimit të punës.

Organizimi, koordinimi dhe kontrollimi i të gjitha fazave deri te përgatitja e dokumentacionit ndërtimor është vetëm një segment i përgatitjes para aplikimit për leje ndërtimore dhe ndërtim. Pra, ky udhëzues nuk është një manual i punës, por vetëm një mjet i propozuar si ndihmë gjatë procesit të hartimit të dokumentacionit ndërtimor.

Kapitulli fillestar “Mjetet e projektimit” përzgjedhë mjetet e duhura teknike konvencionale për përpunimin e dosjes së dokumentacionit ndërtimor.

Kapitulli pasues “Koordinimi i përgjithshëm për hartimin e dokumentacionit ndërtimor” jep udhëzime për përdorimin e mjeteve për studimin e projektit.

Personi i cili është përgjegjës për udhëheqjen dhe koordinimin e dokumentacionit ndërtimor, emërohet “Udhëheqës i projektit”. I cili ka për detyrë të sigurojë aplikimin e të gjitha mjeteve dhe rregullave për të udhëhequr dhe koordinuar projektin e përbërë nga një seri procesesh në mënyrë që ai të realizohet sipas kërkesave CILËSI-AFATE-KOSTO të përcaktuara më parë.

1.2 Mjetet e projektimit

Me ndihmën e mjeteve të projektimit arrihet një kuptueshmëri e ndërsjelltë mes ekipit projektues. Këto mjete krijojnë unifikim të paraqitjes grafike, kontrollim dhe shkëmbim të informatave të dokumentacionit ndërtimor.

mor. Këto kanë për qëllim të krijojnë rregulla që sigurojnë kualitet të punës, kujdes ndaj detajeve dhe kostos së ndërtimit dhe reduktim të vëllimit të punës për hartuesit e dokumentacionit ndërtimor.

12.1 Kriteret e kategorizimit

Duke u bazuar në kushtet ndërtimore të diktuar nga dokumentet e planifikimit hapësinor të gjitha informatat duhet të elaborohen deri në atë pikë në mënyrë që idea të formësohet në një strukturë të ndërtuar. Këto informata duhet të kategorizohen në bazë të prejardhjes e deri te destinimi i tyre.

Zakonisht këto informata kategorizohen sipas kriterëve të poshtëcekura:

- Koncepti dhe shpërndarja e informatave në mes hartuesve të dokumentacionit ndërtimor (arkitektit dhe inxhinierëve të të gjitha fazave të ndërtimit)
- Materializimi i idesë për ndërtimin (studimi i projektit, zbatimi dhe realizimi)
- Zbatimi (kalimi i informatave te kontraktuesit për realizim)
- Kontrollimi

12.2 Rregullat e paraqitjes grafike

Përpara se profesionistët/projektuesit të fillojnë punën për përgatitjen e dosjes së dokumentacionit ndërtimor, udhëheqësi i projektit adapton rregulla të cilat unifikojnë paraqitjen grafike.

Rregullat e paraqitjes grafike kryesisht kanë të bëjnë me:

- Formatin e fletave
- Kornizat
- Përpjesën
- Elementet e tekstit
- Principet e dispozitave grafike
- Teknikat e vizatimit

Këto rregulla të prezantimit përzgjidhen si-

pas rastit konkret i cili do të prezantohet në kuadër të dokumentacionit ndërtimor.

12.3 Përmbajtja e dokumentacionit ndërtimor për aplikim për leje ndërtimore

Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe Ligjin nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, si dhe udhëzimet administrative në fuqi, përmbajtja e dokumentacionit ndërtimor parashihet të definohet në Kodin e Ndërtimit. Ky udhëzues ka për qëllim unifikimin e mënyrës së paraqitjes të dokumentacionit ndërtimor si dhe të definojë llojet e projekteve ([Shtojca C](#)) duke u bazuar në nivelin e përmbajtjes dhe paraqitjes grafike të tyre.

12.4 Lista kontrolluese e dokumentacionit ndërtimor

Lista kontrolluese kryesisht përmban udhëzimet mbi dokumentacionin e nevojshëm dhe përgjegjësit e të gjitha fazave për hartim të projektit.

Për udhëheqësin e projektit kjo listë është një mjet i rëndësishëm për organizimin dhe udhëheqjen e hartimit të dokumentacionit ndërtimor. Para fillimit të punëve, udhëheqësi i projektit duhet të caktojë numrin, renditjen dhe përmbajtjen e dokumenteve të nevojshme për fazat e ndryshme të punëve. Me ç'rast udhëheqësi i projektit do të përgatis një listë të përkohshme të punëve, ku edhe do të përcaktojë përmbajtjen e dosjeve të ndryshme të dokumentacionit ndërtimor.

Ky aktivitet do të rezultojë me një listë definitive të dokumentacionit ndërtimor.

Dobia e listave kontrolluese nuk është vetëm definimi i përmbajtjes së dosjeve të dokumentacionit ndërtimor por edhe për t'i ofruar udhëheqësit të projektit një mjet të rëndësishëm për udhëheqje. Kjo listë lehtëson edhe detyrat e mëposhtme:

- Shkëmbimi dhe kontrollimi i punëve për

- projektuesit e të gjitha fazave
- Përditësimi i modifikimeve të bëra në dokumentacionin ndërtimor
- Bartja e informatave tek zbatuesit

12.5. Shkëmbimi i informatave të dokumentacionit ndërtimor

Shkëmbimi i informatave (përditësimet) të dokumentacionit ndërtimor mes hartuesve dhe zbatuesve të ndryshëm duhet të organizohet në mënyrë që informatat e nevojshme të arrijnë në kohën dhe vendin e duhur. Shkëmbimi i gabueshëm i informatave mund të ndikojë negativisht në projekt. Sipas mundësive dhe nevojave shkëmbimi i informatave bëhet në formë të dosjeve të kompletuara të dokumentacionit ndërtimor në çdo fazë të veprimit dhe i përcillet të gjithë hartuesve të të gjitha fazave të projektit.

Shkëmbimi i dokumentacionit ndërtimor bëhet në të gjitha rastet, pavarësisht karakteristikave dhe organizimit të punëve. Hartuesit dhe zbatuesit duhet të kenë një skemë të shkëmbimit të informatave.

Shtojca A ilustron shpërndarjen e planeve gjatë ndërtimit. Ky shembull tregon se si shtellohet shkëmbimi i dokumentacionit ndërtimor për punimet relativisht komplekse, nga faza e para-projektimit e deri tek faza e përfundimit. Për punimet jo komplekse procesi mund të thjeshtësohet.

13. Sigurimi i kualitetit të dokumentacionit ndërtimor

Kualiteti i dokumentacionit ndërtimor sigurohet kryesisht nga mënyra e kontrollimit, ku të gjithë pjesëmarrësit e shohin dhe përcjellin procesin e intervenimeve si dhe afatet kohore.

Vetëm kontrollimi i rreptë i të gjitha fazave të punës do t'i mundësojë përgjegjësit të sigurojnë kualitetin dhe plotësimin e kërkesave. Prandaj për sigurim të kualitetit janë të rëndësishme:

- Shqyrtimi i dokumentacionit ndërtimor (kontrollimi i projektit)
- Shkëmbimi i informatave të dokumentacionit ndërtimor (kontrollimi i afatit-vonesave)
- Koordinimi i procesit për evitimin e kundërshtimeve dhe mos përputhjeve në mes të hartuesve të të gjitha fazave (kontrollimi i përputhshmërisë)
- Kontrollimi i projektit bëhet për të siguruar saktësinë e planeve (vizatimet dhe llogaritjet), lexueshmërinë dhe përmbajtjen në tërësi.

Kontrollimi i afateve - vonesave - bëhet me qëllim që ato të respektohen gjatë krijimit dhe shpërndarjes së dosjeve të planeve.

Kontrolli i përputhshmërisë ka për qëllim të sigurojë që propozimet nga aktet e ndryshëm dhe pjesëmarrësit në hartimin e dokumentacionit ndërtimor, të jenë në harmoni me njëra - tjetrën. Për kontrollin e përmbajtjes së dokumentacionit ndërtimor dhe kontrollit të skemave të shkëmbimit, rekomandohet që të përdoret lista kontrolluese (checklist) nga udhëheqësi i projektit.

Listat për kontrollimin e kualitetit të punëve janë lista që ndihmojnë udhëheqësin e punëve gjatë hartimit dhe shqyrtimit të projektit.

14. Koordinimi i përgjithshëm i hartimit të dokumentacionit ndërtimor

14.1. Të përgjithshme

Me koordinim të përgjithshëm, gjatë hartimit të projektit nënkuptohet organizimi dhe zhvillimi i të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura me projektimin dhe ndërtimin. Kjo detyrë vë në dukje përgjegjësinë e udhëheqësit të projektit, i cili gjithashtu merr përsipër në mënyrë të pakundërshtueshme anën teknike, ekonomike, ligjore dhe afatet kohore.

14.2 Organizimi

Me organizim nënkuptohet krijimi i kushteve të nevojshme për mbarëvajtjen e përgjithshme të dokumentacionit ndërtimor, duke u mbështetur në masat organizative të ndërmarra në interes të përgjithshëm të veprimit, e sidomos në:

- Organizimin gjeneral të veprimit
- Fazat e zhvillimit operativ
- Fazat e realizimit
- Shpërndarjen e dokumentacionit
- Autoritetet përgjegjëse të përfshira

Sa i përket hartimit të dokumentacionit ndërtimor në kuptim të plotë, preferohet të merren masat në vazhdim:

- Caktimi i rregullave të paraqitjes grafike¹
- Përcaktimi i pjesëve të projektit
- Krijimi i skemës për shpërndarjen e dosjeve të projektit²

Modifikimet në projekt duhet të kryhen sipas rregullave të qarta.

14.3 Zhvillimet (plani dinamik)

Me zhvillimet e projektit nënkuptohet kontrollimi i të gjitha fazave të projektit dhe afateve kohore si dhe saktësisë së zbatimit të aktiviteteve të projektit.

Plani dinamik ka të bëjë me ndërmarrjen e masave për të siguruar zbatimin në kohë dhe cilësitë e të gjitha aktiviteteve, si dhe përditësimin e modifikimeve dhe korrigjimeve të bëra në dokumentacionin ndërtimor. Duhet të insistohet në përditësimin final të planit dinamik, ku shpeshherë nën presionin e obligimeve të reja, përditësimi neglizhohet.

Ky dokument përfundimisht shërben si bazë operative e punës, për çdo lloj të propozuar të ndërtimit si p.sh.: ndërtim i ri, rindërtim, rrënim ose riparim.

1 Shiko shtojcën B
2 Shiko shtojcën A

2 ELEMENTET TEKNIKE KONVENCIONALE

2.1 Qëllimi dhe renditja

Mbështetja tek elementet teknike konvencionale mundëson thjeshtësimin dhe unifikimin e përmbajtjes dhe paraqitjes grafike të projektit.

Kjo vlenë si për projektet e punuara me dorë, ashtu edhe për ato të punuara me kompjuter. Shumica e programeve CAD janë të pajisura me vegla të nevojshme të cilat na mundësojnë përcjelljen e këtyre udhëzimeve si dhe adaptimin e tyre.

2.2 Shembujt e zbatimit sipas kornizës logjike

Elementet teknike konvencionale kanë të bëjnë me të gjitha fushat e ndërtimit. Rekomandohet që këto të përdoren në mësimdhënie si dhe në praktikë, në mënyrë që efekti i racionalizimit të pritur të jetë optimal. Rekomandohet që niveli i prezantimit ose paraqitjes grafike të dokumentacionit ndërtimor të bazohet në llojin e projektit. Bazuar në praktikat profesionale, llojet ose nivelet e projekteve janë si në vijim:

Projekti konceptual - Koncepti/Idea

Projekti ideor - Formësimi i idesë

Projekti kryesor - Zbatimi

Projekti i punëve të kryera - Realizimi

2.2.1 Projekti konceptual - Paraprojekti

Paraqitja e parë grafike pas detyrës projektuese.

Projekti konceptual përcakton konceptin e përgjithshëm, karakteristikat teknike, teknologjike dhe ekonomike si dhe arsyeshmërinë për ndërtimin e strukturës. Në mënyrë më specifike, ai përmban të dhëna për makro lokacionin e ndërtimit; mënyrën

e sigurimit të qasjes në infrastrukturë, siç janë ajo elektrike, hidro-teknike, telekomunikimi, transporti dhe të tjera; alternativat e mundshme për projekte hapësinore dhe arkitektonike si dhe funksionaliteti dhe efikasiteti ekonomik i projektimit.

Dosja e projektit konceptual – hartuar nga arkitekti

Dosja e projektit konceptual hartohet duke u bazuar në kushtet ndërtimore të diktuar nga dokumentet e planifikimit hapësinor ose mbi bazën e rrezës prej pesëdhjetë (50) metrave nga kufiri i parcelës ku planifikohet ndërtimi. Përgjegjës për hartimin e kësaj dosje është arkitekti në bashkëpunim me gjeodetin. Pjesa grafike dhe tekstuale e kësaj dosje mund të përmbajë informatat në vijim, por nuk është kufizuar vetëm në ato pasi që informatat mund të dallojnë në varësi prej llojit të ndërtimit:

I. Informata mbi karakteristikat e lokacionit të gjerë;

- Planin e lokacionit në përpjesë 1:500/1000/2500 i cili përmban:
- Parcelat kadastrale me numër dhe ndërtesat fqinje
- Izohipsat
- Pozicionimin e ndërtesës së propozuar në parcelë sipas kushteve ndërtimore

II. Bazat, prerjet dhe dukjet e ndryshme të paraqitura në mënyrë skematike pa organizim të brendshëm dhe pa detaje

III. Vëllimin e ndërtimit

Paraqitja e kësaj dosje bëhet në mënyrë të lirë pa iu referuar elementeve teknike konvencionale (shih shembullin në shtojcën C).

2.2.2 Projekti ideor

Paraqet nivelin e dytë të projektit i cili hartohet duke u bazuar në projektin konceptual. Projekti ideor përcakton pozitën, kapacitetin, karakteristikat arkitektonike, teknike, teknologjike dhe funksionale të ndërtimit; elementet organizative për aktivitetet ndërtimore; elementet e mirëmbajtjes së ndërtimit; vlerësimin e vlerës së punëve për punët

ndërtimore.

Projekti ideor duhet të jetë i formësuar dhe funksional deri në atë pikë ku ai është i definuar dhe të mos ketë ndryshime madhore gjatë ekzekutimit. Përgjegjës për hartimin e kësaj dosje është arkitekti në bashkëpunim me gjeodetin dhe inxhinierët e fazave tjera të ndërtimit. Pjesa tekstuale e projektit ideor përmban një përshkrim përmbledhës të projektit posaçërisht me materialet e propozuara, instalimet dhe pajisjet teknologjike, që i shërbejnë ndërtimit që nëpërmjet masave teknike të mbrojtë mjedisin, si dhe një përshkrim të çdo studimi të mëparshëm gjeologjik/gjeomekanik, sizmologjik dhe kushtet hidrologjike dhe klimatike. Projekti ideor poashtu përmban vlerësimin e kostos totale të ndërtimit.

Dosja e projektit ideor – hartuar nga arkitekti dhe ekipi profesional

Pjesa grafike e kësaj dosje mund të përmbajë informatat në vijim, por nuk është kufizuar vetëm në ato pasi që informatat mund të dallojnë në varësi prej llojit të ndërtimit:

I. Plani i situacionit, në përpjesë 1:500/200

- Veriu
- Kufijtë dhe numrat e parcelave
- Rugët dhe shtigjet
- Ndërtesat përreth dhe gabaritin e tyre
- Gabariti i ndërtimit të propozuar
- Qasjet në parcelë
- Sipërfaqet e gjelbëruara
- Parkingjet
- Etazhiteti i ndërtimit të propozuar
- Pusetat
- Shtyllat elektrike
- Dimensionet dhe kuotat

II. Bazat e bodrumit/suterenit/përdhësës dhe kateve, në përpjesë 1:100

- Veriu
- Parteri
- Qasjet në ndërtesë
- Shkallët dhe rampat-pjerrinat
- Organizimi i brendshëm
- Sipërfaqet neto dhe bruto
- Vëllimi i kthinave neto
- Numërimi i kthinave
- Dimensionet dhe kuotat
- Shenjat e referimit të prerjeve dhe detajeve

III. Prerjet, në përpjesë 1:100

- Organizimi i prerjes së strukturës
- Emërtimi dhe numërimi i kthinave
- Dimensionet dhe kuotat e nivelit
- Shenjat e referimit të prerjeve dhe detajeve
- Vija e prerjes së terenit të propozuar
- Vija e prerjes së terenit natyral

IV. Dukjet, në përpjesë 1:100

- Kuotat e nivelit
- Vija e prerjes së terenit të propozuar
- Vija e prerjes së terenit natyral
- Paraqitja e elementeve nën tokë

V. Plani i qasjes në kanalizim, në përpjesë 1:100/200

- Pozicionimi i pusëve të ujërave të zeza
- Pozicionimi i pusëve të ujërave të pastërta
- Shpërndarja e rrjetit të kanalizimit të propozuar dhe kyçja në infrastrukturë publike
- Specifikacionet mbi gypat e kanalizimit si trashësia e gypave, materialet dhe kuotat e nivelit të pozicionimit

Paraqitja e kësaj dosje bëhet duke iu referuar elementeve teknike konvencionale (shih shembullin në shtojcën C).

2.2.3. Projekti kryesor

Paraqet nivelin e tretë të projektit i cili hartohet duke u bazuar në projektin ideor. Projekti kryesor përcakton ndërtimin teknologjik dhe arkitektonik, karakteristikat teknike dhe të eksploatimit të strukturës me pajisje dhe instalime, së bashku me elaborimin e të gjitha hollësive të nevojshme për ndërtimin e ndërtesës dhe vlerës së punëve për ndërtim. Projekti kryesor përmban projektin e të gjitha punëve të inxhinierisë në mënyrë të detajuar nga ana arkitektonike, statike dhe e instalimeve, duke përfshirë edhe përshkrimin teknik, planin dinamik të punëve dhe inspektimeve, paramasën dhe parallogarinë e ndërtimit. Projekti kryesor përveç pjesës së arkitekturës, ndahet në disa kapituj:

Dosja e projektit kryesor - hartuar nga arkitekti

I. Bazat e bodrumit/suterenit/përdhësës/katëve dhe kulmit, në përpjesë 1:50

- Veriu
- Parteri
- Materializimi i elementeve të strukturës me shrafura përkatëse
- Materializimi i konstruksionit
- Materializimi hapjeve, dyerve dhe dritareve, mënyra e hapjes dhe montimit të tyre
- Tabela e specifikimit të kthinave e cila përmban numërimin e kthinave, kuotat e nivelit të pllakës, kuotat e nivelit të dyshemesë, materializimin e shtresës së fundit të dyshemesë dhe mureve
- Dimensionet e jashtme që dimensionojnë strukturën, hapjet, gabaritin dhe totalin e ndërtesës
- Dimensionet e brendshme që dimensionojnë hapjet, gabaritet dhe totalin
- Kuotat absolute dhe relative
- Pozicionimi i pajisjeve sanitare në WC, banjo dhe kuzhina
- Shenjat e referimit të prerjeve dhe detajeve

II. Prerjet, në përpjesë 1:50

- Materializimi i elementeve të strukturës me shrafura përkatëse
- Kuotat relative të lartësisë në pllakë, dysheme dhe tavan
- Kuotat absolute në secilën pllakë
- Numërimi dhe emërtimi i kthinave të prera me specifikacione të shtresave të dyshemesë dhe tavanit
- Dimensionimet e jashtme të lartësive të katit, hapjeve dhe meskateve
- Dimensionimet e brendshme të meskateve dhe hapësirës së pastër
- Këndet e pjerrtësisë së kulmeve dhe rampave-pjerrrinave të prera dhe përqindja e ramjeve
- Materializimi i shtresave të dyshemesë
- Shenjat e referimit të prerjeve dhe detajeve

III. Dukjet, në përpjesë 1:50

- Materializimi i fasadës dhe specifikacionet e saj
- Kuotat e nivelit

- Shenjat e referimit të prerjeve dhe detajeve
- Paraqitja e elementeve nën tokë

Pjesa grafike – detajet e projektit – hartuar nga arkitekti

- I. Detajet në plan dhe prerje, përpjesa 1:20
 - Detaje të dymyre-dritareve
 - Detajet konstruktive
 - Verbueset e dymyre-dritareve (roleta)
- II. Detajet e kuzhinës, banjës dhe WC-së
 - Planet dhe prerjet, në përpjesë 1:20
 - Paraqitja e pajisjeve sanitare dhe dimensionimi i akseve të kyqjeve.

Dosja e projektit kryesor – hartuar nga inxhinieri i ndërtimtarisë

- I. Plani i pozicionimit, në përpjesë 1:50
- II. Plani i armaturës, dimensionimi i elementeve konstruktive, në përpjesë 1:50
- III. Detajet e armimit, në përpjesë 1:20

Dosja e projektit kryesor – hartuar nga inxhinierët e instalimeve të ndërtimit

- I. Plani koordinues për instalime në ndërtesë (përdhësë, suteran, bodrum dhe kate) në përpjesë 1:50
 - Pozicionimi i elementeve të instalimeve elektrike
 - Pozicionimi i elementeve të instalimeve makinerike
 - Pozicionimi i elementeve të instalimeve hidroteknike

Paraqitja e këtyre dosjeve bëhet duke iu referuar elementeve teknike konvencionale (shih shembujt në shtojcën C).

SHTOJCA A

Në **Shtojcën A** paraqiten mënyrat e përpunimeve të dosjeve të projekteve nëpër faza.


A.1 Dokumentacioni teknik i hartuar nga arkitekti

Lloji i dokumentacionit teknik	Dosja e projektit konceptual	Dosja e projektit ideor	Dosja e projektit kryesor	Dosja e projektit ekzekutues	Dosja e projektit zbatues	Dosja e planeve të punëve të kryera
Fazat e operimit	Para Projekti	Projekti		Përgaditja për ekzekutim	Ekzekutimi i ndërtimit	Faza finale
Qëllimi: Cilat objektiva duhet arritur dosjet e planeve?	Plotësimin e kriterëve të kushteve ndërtimore nga planet hapësinore	Definimi i ndërtimit deri në atë pikë ku të mos ketë ndryshime të mëdha	Marrja e lejës ndërtimore	Marrja e ofertave nga kontraktorët dhe furnizuesit për ndërtim	Përgaditja e ekzekutimit të punëve	Përpunimi i dokumentacionit për nevojat të mirëmbajtjes ose të renovimit të ardhshëm
Pranuesi i dokumentacionit: Kujt i dedikohet dokumentacioni?	Organi kompetent dhe të gjithë ekspertët të involvuar për realizimin e ndërtimit	Organi kompetent dhe të gjithë ekspertët të involvuar për realizimin e ndërtimit	Organi kompetent dhe të gjithë ekspertët të involvuar për realizimin e ndërtimit	Organi kompetent dhe të gjithë ekspertët të involvuar për realizimin e ndërtimit. Kontraktuesit, furnitorët dhe tenderuesit	Organi kompetent dhe të gjithë ekspertët të involvuar për realizimin e ndërtimit, investitori dhe kontraktuesi	Mirëmbajtësit e ndërtimit
Permbajtja: Cilat të dhëna i përmban dokumentacioni teknik?	Koncepti i vëllimit, pozicionimi gjen-eral i ndërtimit dhe elementet estetike	Projektin konceptual i përpunuar deri në atë formë që arrihen kriteret e marrjes së lejës	Të gjitha të dhënat e nevojshme për ekzekutim, llogaritjet e strukturës dhe materializimin e saj	Të gjitha të dhënat e nevojshme për ekzekutim dhe përshkrimi i punëve	Të gjitha të dhënat e nevojshme për ekzekutim	Të gjitha të dhënat e ndërtimit të përditësuara në Projektin Kryesor
Të dhënat grafike: Në cilën mënyrë informacioni duhet të transmetohet?	Plani i lokacionit 1:1000/500 Bazat, prerjet dhe dukjet në përpjesë 1:500/200/100 në mënyrë skematike	Plani i situacionit 1:1000/500, Bazat, prerjet dhe dukjet në përpjesë 1:200/100/50	Projekti i detajizuar në përpjesë 1:50. Fazat nga inxh. e ndërtimtarisë. në përpjesë 1:50 Detajet e ndryshme në përpjesë 1/20/10/5	Pjesët grafike të nevojshme për ekzekutim 1:100/50/20/10/5	Libri i ndërtimit, Kartela inspektive, Elaborati për siguri dhe shëndet në vendndërtim Testet dhe çertifikatat e cilësisë së materialeve, Deklaratat e testimeve të instalimeve	Projekti kryesor i realizuar në përpjesë 1:100/50
Të dhënat bazë: Cilat të dhëna bazë janë të nevojshme për përpilimin e dokumentacionit teknik?	Plani dinamik i punëve të paramenduara; Kushtet ndërtimore; Matjet gjeodezike të lokacionit	Projekti konceptual i aprovuar, analizat preliminare statike; pre-dimensionimi i strukturës	Projekti ideor i aprovuar; projektin e instalimeve të ndërtimit; Planin për mbrojtje nga zjarri	Projekti ekzekutues dhe plani i detajeve, statika e objektit, projektin e instalimit ndërtimor, koncepti i rregullimit të enterierit	Projekti ekzekutiv, dhe plani i detajeve, statika e objektit, projektin e instalimit ndërtimor, koncepti i rregullimit të enterierit	Projekti ekzekutiv i përditësuar me ndryshimet eventuale në kantier.

A.2 Dokumentacioni teknik i hartuar nga inxhinierët e instalimeve të ndërtimit

Lloji i dokumentacionit teknik	Dosja e projektit konceptual	Dosja e projektit ideor	Dosja e projektit kryesor	Dosja e projektit ekzekutues	Dosja e projektit zbatues	Dosja e planeve të punëve të kryera
Fazat e operimit	Para Projekti	Projekti		Përgaditja për ekzekutim	Ekzekutimi i ndërtimit	Faza finale
Qëllimi: Cilat objektiva duhet arritur dokumentacioni teknik?	Zgjidhje gjenerale; Propozimi i përgjithshëm i projektit konceptual; Koordinimi i përgjithshëm i instalimeve të ndërtimit	Projekti i instalimeve të ndërtimit të predimensionuar të përkohshëm; Koordinimi i detajuar i distribuimit linear të teknologjive	Studimi i detajeve i cili shërben si bazë e planit ekzekutiv të arkitektit	Marrja e ofertave nga kontraktorët dhe furnizuesit për ndërtim	Planet definitive për ekzekutim që shërbejnë si bazë për montimin e instalimeve	Përditësimi i të gjitha ndryshimeve eventuale gjatë ekzekutimit për instalimet e ndërtimit
Pranuesi i dokumentacionit: Kujt i dedikohet dokumentacioni?	Mirëmbajtësit e ndërtimit; Arkitekti; Inxhinierit të ndërtimtarisë; Inxhinierat e tjerë të instalimeve të ndërtimit dhe Organit kompetent	Mirëmbajtësit e ndërtimit; Arkitekti; Inxhinierit të ndërtimtarisë; Inxhinierat e tjerë të instalimeve të ndërtimit dhe Organit kompetent	Mirëmbajtësit e ndërtimit dhe Arkitekti	Mirëmbajtësit e ndërtimit; Arkitekti; Inxhinierit të ndërtimtarisë; Inxhinierave të tjerë të instalimeve të ndërtimit dhe Kontraktuesi	Mirëmbajtësit e ndërtimit; Arkitekti; Inxhinierit të ndërtimtarisë; Inxhinierave të tjerë të instalimeve të ndërtimit dhe Kontraktuesi	Arkitekti; Mirëmbajtësit e ndërtimit
Permbajtja: Cilat të dhëna i përmban dokumentacioni teknik?	Furnizimi kryesor me energji; Vertikalet kryesore dhe shpërndarjet lineare	Instalimet për shpërndarje të fluideve; Instalimet për evakuime; struktura e dispozitave për instalimet e ndërtimit; Planet e koordinimit	Detajet relative për instalimet e ndërtimit	Detajet e nevojshme për ekzekutimin e ndërtimit	Detajet e nevojshme për ekzekutimin e instalimeve të ndërtimit	Planin e ekzekutimit; Planin e mirëmbajtjes; Planin e funksionimit të instalimeve
Të dhënat grafike: Në cilën mënyrë informacioni duhet të transmetohet?	Planin e situacionit; Skemat, Bazat e ndryshme Prerje skematike	Planet gjenerale dhe planet e dispozitave; skemat e ndryshme; bazat e ndryshme; prerjet	Bazat dhe prerjet	Skemat e funksionimit; bazat e ndryshme dhe prerjet	Skemat e funksionimit; bazat e ndryshme, prerjet dhe detajet e ndryshme	Skemat e funksionimit; bazat e ndryshme dhe prerjet; detaje të përditësuara në rast të ndryshimeve eventuale në kantier
Të dhënat bazë: Cilat të dhëna bazë janë të nevojshme për përpilimin e dokumentacionit teknik?	Dosja e projektit konceptual hartuar nga arkitekti	Dosja e projektit ideor hartuar nga arkitekti	Detajet e përcaktuara nga arkitekti	Dosja e projektit ekzekutues hartuar nga arkitekti	Dosja e projektit ideor hartuar nga arkitekti me të gjitha përditësimet	Dosjet e projekteve të përpunuara nga arkitekti, Inxh i ndërtimtarisë të përditësuara me ndryshimet eventuale në kantier

A. 3. Skemë e shpërndarjes së planeve për një ndërtim kompleks



Dosja e planit sipas SIA 400

SHTOJCA B

Në **Shtojcën B** paraqiten elementet teknike konvencionale të paraqitjes grafike të bazuar në ISO standarde

B 1 PLANET

B 1.1. Formatet e fletës

Formati i fletës për printimin e planeve diktohet sipas nevojës. Preferohet të përdoren formatet e fletës të standardit ISO 126 A³ (A4 deri te A0). Në raste të veçanta kur ky standard nuk përshtatet, mund të përdoret formati A4 një njësi në dispozicion tek një tjetër format. Korniza e përcakton sipërfaqen e printimit e cila duhet të jetë më së paku 5 mm nga fundi i fletës.


Formate të ndryshme të serisë A përfitohen duke ndarë në mënyrë të vazhdueshme formatin A0.

Formatet A, të shprehura në mm janë si në vazhdim:

A0	841 x 1189
A1	594 x 841
A2	420 x 594
A3	297 x 420
A4	210 x 297

B 1.2. Palosja

Palosja bazohet në formatin A4. Gjatë palosjes duhet pasur parasysh që titulli i planit të jetë i dukshëm kur plani të paloset. Në faqen e dukshme të planit të palosur duhet të figurojnë informacionet kryesore.




Shembull:

Fleta A0.

Palosja e fletës deri në formatin A4 me orientim horizontal të formatit (Landscape)

C: Legjenda.




Shembull:

Fleta A0.

Palosja e fletës deri tek arritja e formatit A4, në orientim vertikal (Portrait).

Preferohet që të shenjoen palosjet.

C: Legjenda



Shembulli:

Formati i fletës, shumëfishtë të A4.

Preferohet të shenjoen palosjet.

C: Legjenda

B 1.3. Tabelat

B 1.3.1 Dimensionet dhe pozicionimet

Tabela si pjesë përbërëse e planit përbëhet nga fushat në të cilën vendoset legjenda dhe sipas nevojës në të mund të shtohen edhe fusha tjera për vendosjen e informacioneve të ndryshme.

Tabela zakonisht vendoset në anën e djathtë të planit. Në mes kornizës në të cilën është vendosur legjenda dhe pjesës anësore dhe të poshtme të fletës duhet të jetë një distancë prej 5mm. Fushat shtesë të tabelës vendosen në pjesën e poshtme të saj.

3 ISO 216:2007 Writing paper and certain classes of printed matter — Trimmed sizes — A and B series, and indication of machine direction

B 1.3.2. Përmbajtja

B 1.3.2.1 Legjenda

Tabela mund të përmbaj të dhënat në vazhdim:

- Kompania projektuese:
 - Emri
 - Adresa
 - Kontakti
- Përmbajtja:
 - Emërtimi i projektit
 - Emërtimi digjital i projektit
 - Dosja e projektit (p.sh.: projekti konceptual, ideor, kryesor, numri referent i lejes ndërtimore, etj.)
 - Titulli i planit-fletës
 - Lokacioni (kuotat, prerja, lartësia)
 - Modifikimet
- Autori i projektit:
 - Emri
 - Adresa
 - Kontakti
- Identifikimi i planit:
 - Numri i lëndës
 - Numri i planit-fletës
 - Përpjesa
 - Përditësimi
 - Fusha për nënshkrimin e autorit të projektit
 - Fusha për nënshkrimin e përgjegjësit (në rast se autori duhet të mbikqyret)
 - Informacione mbi software-in CAD të përdorur
 - Format i planit-fletës

B 1.3.2.2 Fushat shtesë

Në fushën shtesë mund të figurojnë pikat përcaktuese të skemës, shenja e veriut, përpjesa e vizatimit, shpjegimet shtesë apo përcaktimi i shtresave-layerave (në CAD) dhe të autoreve të tyre.

B 1.3.3. Përbërja

Përbërja e emërtimeve nuk i nënshtrohet rregullave strikte. Në praktikë, ndarja e legjendës, për fletët e formatit A0-A2, bëhet në 4 hapësira. Sipërfaqet e tabelës përshtaten sipas nevojës.




Figura 1. Shembulli i pozicionimit të legjendës dhe hapësirave⁴

Pozicionimi i legjendës në formatet A3 dhe A4 mund të bëhet në anën gjatësore apo tërthore të fletës.




Figura 2. Vendosja e tabelës në plan

4

ISO 9431:1990 – Construction drawings – Spaces for drawing and for text, and title blocks on drawing sheets.

B 1.3.4. Përpjesa

Në legjendë paraqitet përpjesa e përdorur në plan.

Përpjesa	Punët e zakonshme të arkitektit	
1:1000 1:5000 1:2000	Plani i lokacionit	
1:1000 1:500	Plani i makro lokacionit Plani kadastral	
1:200	Plani i situacionit Projekti ideor	
1:100	Projekti ideor	
1:50	Projekti kryesor-ekzekutiv	
1:20 1:10 1:5 1:1	Plani i detajeve	Plani zbatues

Figura 3. Përpjesa e përdorur për vizatimet teknike⁵




Figura 4. Shembull i skalimetrit për planet, në përpjesë 1:20

Reduktimi i përdorimit të teknikave theksohet çdo ditë e më shumë, rekomandohet që në çdo vizatim të përdoret skalimetri. Kjo na mundëson që të dimensionojmë përafërsisht, në raste kur vizatimi është i zvogëluar apo nuk është në përpjesë.

Shkallët e zvogëlimit ose zmadhimit duhet të përcaktohen si të tilla:

Kategoria	Përpjesë të rekomanduara
Shkallë e zmadhimit	50:1; 20:1; 10:1; 5:1; 2:1
Shkallë e plotë	1:1
Shkallë e zvogëlimit	1:2; 1:5; 1:10; 1:20; 1:50; 1:100; 1:200; 1:500; 1:1000; 1:2000; 1:5000; 1:10000

Tabela 1. Përpjesët e rekomanduara të cilat duhet përdorur në vizatimet teknike⁶

5 Norme suisse SIA 400:200 Construction - Élaboration de dossier de plans dans le domaine du bâtiment -
6 ISO 5455:1979 – Technical drawings — Scales

B 2 ELEMENTET E TEKSTIT

B 2.1 Të përgjithshme

Kërkesat fillestare në lidhje me tekstin janë:

- Lexueshmëria
- Fonti
- Mundësia e digjitalizimit dhe mundësia e konvertimit të tekstit në formate të ndryshme

Rregullat mbi madhësinë dhe vendosjen e tekstit aplikohen me shkronjat dhe numrat e shkruara si bllok shkronja, dorëshkrim, CAD ose teknika të tjera.

B 2.2 Rregulla e përbërjes

Për arsye praktike, teksti i shkruar në bllok shkronja do të bëhet përgjithësisht me shkronja të mëdha.

Për fjalët dhe tekstin e shkruar me CAD mund të jenë me shkronja të mëdha apo të vogla, në mënyrë që të bëhen më të lexueshme.

Përzgjedhja e dispozitës së numrave dhe teksteve sipas kriterëve grafike kontribuojnë poashtu në lexueshmërinë e vizatimit.

Teksti paraqitet në atë mënyrë që të mundësojë leximin nga poshtë apo nga e djathta e fletës.

B 2.3 Dimensionet e karaktereve

Për dimensionet e karaktereve do të merren parasysh rregullat në vazhdim:

- Lartësia e H-së së madhe shërben si bazë në dimensionet e karaktereve të tjera.
- Dimensionet e karaktereve zgjedhen në funksion të përpjesëve të planit.
- Trashësia e vijave përfaqëson së paku 1/10 e lartësisë H.

B. 3. VIJAT⁷

B. 3.1. Trashësia e vijave

Në të njëjtin vizatim preferohet të përdoren jo më shumë se tri trashësi të ndryshme të vijave. Rekomandohet që të përdoret një diferencim i qartë:

Grupet e vijave	Vijat e holla	Vijat e trasha	Vijat shumë të trasha	Trashësia e vijave për simbolet grafike
0.25	0.13	0.25	0.5	0.18
0.35	0.18	0.35	0.7	0.25
0.5	0.25	0.5	1	0.35
0.7	0.35	0.7	1.4	0.5
1.0	0.5	1	2	0.7

Caktimi i trashësisë së vijave përcaktohet sipas formatit të planit, përpjesës dhe shkallës së zvogëlimit.

Përdorimi i vijave më të holla se 0.25mm këshillohet vetëm nëse teknika e kopjimit ose shkalla e zvogëlimit mundëson atë.

⁷ ISO 128-20 – Technical drawings — General principle of presentation – Part 20: Basic convention of lines

B 3.2 Llojet e vijave

Vijat e paraqitura në vazhdim janë vijat që zakonisht përdoren në vizatimet e planeve:

Nr.	Prezantimi grafik	Përshkrimi
01		Vijë e plotë
02		Vijë e ndërprerë
03		Vijë e ndërprerë e gjerë
04		Vijë e ndërprerë me vija të gjata të ndërprera me pikë
05		Vijë e ndërprerë me vija të gjata të ndërprera me dy pika
06		Vijë e ndërprerë me vija të gjata të ndërprera me tri pika
07		Vija me pika
08		Vijë e ndërprerë me vija të gjata dhe të shkurta
09		Vijë e ndërprerë me vija të gjata dhe dy vija të shkurta
10		Vijë e ndërprerë me vijë dhe pikë
11		Vijë e ndërprerë me dy vija dhe një pikë
12		Vijë e ndërprerë me një vijë dhe dy pika
13		Vijë e ndërprerë me dy vija dhe dy pika
14		Vijë e ndërprerë me një vijë dhe tri pika
15		Vijë e ndërprerë me dy vija dhe tri pika

Figura 5: Llojet bazike të vijave


Prezantimi grafik	Përshkrimi
	Vijë e plotë e lakuar në mënyrë uniforme
	Vijë e plotë e lakuar në formë spirale
	Vijë e plotë në formë zig-zag
	Vijë e dorës së lirë

Figura 6: Variacione të vijave bazike




Figura 7: Kombinimet e dy vijave bazike



Figura 8: Kombinimi i vijës me elemente të mbivendosura



Figura 9: Kombinimi i vijës me elemente gjeometrike




Figura 10: Kombinimi i dy vijave paralele me elemente të mbivendosura

B 3.3. Rastet e përdorimit

Nr.	Përshkrimi dhe prezantimi grafik	Aplikimi	Referenca në ISO
01.2	Vijë e plotë hollë 	1. Kufijtë e materialeve të ndryshme në dukje dhe prerje (si alternativë shih. 01.2.2)	7519
		2. Shrafurat	4069
		3. Diagonalet për treguesit e hapjeve, vrimave dhe oazave	7519
		4. Shigjetat te shkallët, rampat-pjerrinat	7519
		5. Rrjetat modulare, faza e parë (nëse kërkohet mund të prezantohen edhe me ngjyra)	8560
		6. Vijat e shkurta që prezantojnë qendrën	----
		7. Vijat e zgjatura	129
		8. Vijat e dimensionimit dhe përfundimet e tyre	129
		9. Vijat e referimit	129
		10. Kufijtë ekzistues në planet e situacioneve (si alternativë shih 02.1.1)	11091
		11. Vijat në dukje të elementeve (si alternativë shih 01.2.3)	-----
		12. Prezantimi i thjeshtë grafik i dyerve, dritareve, shkallëve dhe elementeve të tjera (si alternativë shih 01.2.4)	7519
		13. Kufizimet e detajeve	-----
	Vijë e plotë e vazhdueshme me zig-zag 	14. Ndërprerja e elementeve në prerje dhe dukje nëse kufiri nuk paraqitet me vijën 04.1 (si alternativë shih 04.1.6)	-----
01.2	Vijë e plotë e trashë 	1. Kufizimet e shrafurave në prerje	7519
		2. Kufizimet e materialeve të ndryshme në dukje dhe prerje (si alternativë shih 01.1.1)	-----
		3. Vijat e elementeve në dukje (si alternativë shih 0.1.1.11)	7519
		4. Paraqitja e thjeshtë grafik i dyerve, dritareve, shkallëve dhe elementeve të tjera (si alternativë shih 01.2.4)	7519
		5. Rrjetat modulare, faza e dytë (nëse kërkohet mund të prezantohen edhe me ngjyra)	8560
		6. Shenjat për referimin e prerjeve dhe dukjeve	8048
		7. Kufijtë e propozuar në planet e situacionit	11091
01.3	Vijë e plotë shumë e trashë 	1. Vijat e dukshme të elementeve në prerje kur nuk përdoren shrafurat	7519
		2. Armaturat (shih 02.3.1)	3766
		3. Vijat me rëndësi të veçantë	-----

02.1	Vijë e ndërprerë e hollë 	1. Kufijtë ekzistues në planet e situacionit (si alternativë shih 01.1.10)	11091
		2. Shtigjet	11091
		3. Vijat e fshehura (si alternativë shih 02.2.1)	-----
02.2	Vijë e ndërprerë e trashë 	1. Vijat e fshehura (si alternativë shih 02.2.3)	-----
04.1	Vijë e hollë e ndërprerë me vijë të gjatë dhe pikë 	1. Rrafshet prerëse (vija 04.2 në përfundime dhe ndryshime të drejtimit)	-----
		2. Akset	-----
		3. Vijat e simetrisë (të identifikuar në fundet e saj nga një shigjetë të shkurtër që kthehet në kënd të drejtë)	-----
		4. Korniza e detalit të zmadhuar	-----
		5. Vijat e referencave	-----
		6. Kufijtë parcial ose dukjet e ndërprera, prerjet (veçanërisht për vijat e shkurta për situata të caktuara; shih 01.1.2, 01.2.1, 01.3.1 etj.)	-----
04.2	Vijë e trashë e ndërprerë me vijë të gjatë dhe pikë 	1. Rrafshet prerëse (në fund të vijës ndërrojnë drejtimin për 90°; shih 04.1.1)	-----
		2. Vijat në dukje të cilat janë të vendosura përballë rrafshit prerës	-----
04.3	Vijë shumë e trashë e ndërprerë me vijë të gjatë dhe pikë 	1. Vijë sekondare për përcaktimin e një reference	4463-1;4068
		2. Treguesin e një vije ose sipërfaqes në të cilën duhet të aplikohen rekuizita të veçanta	-----
		3. Kufijtë e kontratave, fazave dhe zonave	-----
05.1	Vijë e hollë e ndërprerë me vijë të gjatë dhe dy pika 	1. Alternativat dhe pozicionet ekstreme të elementeve lëvizëse	-----
		2. Vijat e akseve	-----
		3. Vijat e dukshme të elementeve të afërta	-----
05.2	Vijë e trashë e ndërprerë me vijë të gjatë dhe dy pika 	1. Vijat e elementeve të fshehura në rrafshin prerës	-----
05.3	Vijë shumë e trashë e ndërprerë me vijë të gjatë dhe dy pika 	1. Armatura e tërhequr dhe kabllot	3766
06.1	Vijë me pika 	1. Vijat e elementeve të cilat nuk parashihen në projekt	-----

B 4. RASTERAT (MODULET) DHE KOORDINATAT⁸

B 4.1 Rrjetat modulare të akseve

Rrjeta modulare mundëson ndarjen e konstruksionit në module më të vogla. Një modul primar mund të ndahet në një modul më të vogël sekondar.




Figura 11. Paraqitja grafike e rrjetës modulare




Figura 12. Përdorimi i rrjetës modulare të akseve në një strukturë mbajtëse me mur të jashtëm

B 4.2 Rrjetat modulare të konstruksionit

Rrjeta modulare e konstruksionit paraqet një zhvillim të rrjetës modulare të akseve. Këto rrjeta përdoren si koordinata dimensionale të cilat janë të bazuara në koordinatat dimensionale të modulit ndërkombëtar. Koordinatat modulare (bazuar në ISO) përdoren si mjete të nevojshme për harmonizimin e gjeometrisë së konstruksionit dhe elementeve të tij për përpunimin e planeve.




Figura 13. Paraqitja grafike e rrjetës modulare të konstruksionit




Figura 14. Përdorimi i rrjetës modulare të konstruksionit në një strukturë mbajtëse

⁸ ISO 8560:1986 – Technical drawings -Construction drawings - Representation of modular sizes, lines and grids.

B 4.3. Koordinatat

Në rastet kur bëhet fjalë për ndonjë projekt të shkallës së madhe, për një paraqitje sa më të mirë grafike, mund të inkorporohet edhe rrjeti koordinativ i Agjencisë Kadastrale.




Figura 15. Paraqitja grafike e rrjetit koordinativ




Figura 16. Paraqitja grafike e rrjetës koordinative e kombinuar me rrjetën modulare të akseve.

B 5. DIMENSIONET DHE KUOTAT⁹

B 5.1 Të përgjithshme

